

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË BORDIT
TË INSPEKTIMEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Reforma në inspektime synon konsolidimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së inspektimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik, forcimin e transparencës dhe llogaridhënes në veprimtaritë e inspektimit, lidhur me ndryshimin e qasjeve dhe funksionimit në një këndvështrim ndryshe në riorganizimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në strukturën e re të inspektimit, ku një vend të veçantë luan edhe vendimmarja, hartimi i politikave dhe i standardeve të përgjithshme të inspektimit nga inspektoratet përgjegjëse.

Bordi i Inspektimeve, do të bashkërendojë të gjithë sistemin e inspektimeve ku do të marrë vendimet kryesore strategjike dhe përcaktuese të politikave të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standardeve dhe metodologjive, për shumë aspekte të fushës së inspektimit si:

- ✓ koordinon veprimtarinë e tij, me Inspektorin e Përgjithshëm dhe shkëmben informacione në funksion të garantimit të standardeve të përgjithshme të inspektimit;
- ✓ bashkëpunon me organet e tjera shtetërore, institucione ndërkombëtare, si edhe organizata të tjera me objekt veprimtarie ose ekspertizë në fushën e inspektimit në Republikën e Shqipërisë;
- ✓ ndihmon ministrinë e linjës në bashkërendimin e punës për fushat e inspektimit;
- ✓ shqyrton dhe jep vlerësimin e tij për raportin vjetor të veprimtarisë së çdo fushe inspektimi;
- ✓ shqyrton dhe miraton masat e nevojshme për mirë organizimin e mbledhjeve dhe të veprimtarive të Bordit, si dhe çdo kompetencë tjeter të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e tij.

Krijimi i Bordit të inspektimeve është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimeve në sistemin e inspektimit dhe sigurimit të një njedisi më të rregulluar, më efektiv për zbatimin e ligjeve dhe rregullave në Shqipëri.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve”, është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2025. Projektvendimi është hartuar në zbatim të përcaktimeve në

Relacion për projektvendimin “Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve”

ligjin nr. 99, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe përputhet me Programin Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është shumë i rëndësishëm pasi synon rregullimin e shumë parashikimeve ligjore të bëra në ligjin e ri për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, rregullime këto të domosdoshme edhe për Bordin e Inspektimeve.

Projektvendimi synon të nxjerr disa problematika në sistemin aktual të inspektimit, duke përfshire:

- ✓ Fragmentimin e rregullave dhe standardeve, pra mungesa e një qasjeje të unifikuar për standarde dhe politika që inspektimi çon në një zbatim jo të barabartë të ligjeve dhe rregullave, duke krijuar pasiguri për subjektet e inspektuara **dhe** hapësirë për interpretime subjektive ose abuzim;
- ✓ Mungesa e koordinimit ndërinstitucional, pa një organ qendror që bashkërendon aktivitetet e inspektimit, vështirëson shkëmbimin e informacionit dhe të dhënavë mes institucioneve të ndryshme, çka ndikon negativisht në efikasitetin e përgjithshëm të proceseve të inspektimit;
- ✓ Mungesa e një organi kolegjal, në përcaktimin e qartë të politikave dhe standardeve të inspektimit, mund të çojë në një trajtim të padrejtë të bizneseve dhe konsistencë në vendimmarrje.

Përparësitet e këtij projektvendimi përfshijnë:

- ✓ Përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit;
- ✓ Marrja e vendimeve kryesore të politikave të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standardeve dhe metodologjive për shumë aspekte të fushës së inspektimit;
- ✓ Rritja e cilësisë së inspektimeve;
- ✓ Mbikëqyrje të sistemit të inspektimeve;
- ✓ Zhvillimin e një qasjeje më profesionale ndaj inspektimit, me trajnime të përbashkëta dhe ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira ndërmjet inspektorëve.

Efektet e pritshme janë:

- ✓ Përmirësimi i koordinimit dhe uniformitetit të veprimtarisë inspektuese;
- ✓ Rritja e transparencës dhe llogaridhënieς;
- ✓ Rritja e besueshmërisë së publikut dhe biznesit.

Bashkërendimi i të gjithë sistemit të inspektimeve nga një Bord Inspektimi, i përbërë nga përfaqësues politik të ministritë përgjegjëse për inspektimin, do të marrë vendimet kryesore strategjike dhe përcaktues të politikave të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standardeve dhe metodologjive për shumë aspekte të fushës.

Relacion për projektvendimin "Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve"

Me miratimin e këtij projekt vendimi të Këshillit të Ministrave, funksionimi i këtij bordi do të sjellë një vendimmarje më të përgjegjshme dhe të studiuar mirë, të bazuar në politika zhvilluese dhe racionale, për sa i përket fushës së inspektimit dhe ndërmarrjen e një sërë iniciativash ligjore, që dalin në kohë të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 14, të ligjit nr. 99 datë, 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe përputhet me Programin Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2025.

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendor (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim te Urdhrit Nr. 49 datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve "e-Inspektimi".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Roli i veçantë i kësaj strukture, është i ndërthetur ngushtë me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, të cilat konsistonë në përcaktimin e standardeve dhe politikave të përgjithshme të inspektimit, në përcaktimin dhe miratimin e treguesve të performancës në fushën e inspektimit, si dhe dhënien e mendimit në përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit.

Bordi i Inspektimit, është konceptuar si një organ që bashkërendon politikat dhe përcakton standarde të përgjithshme të inspektimit. Përbërja e këtij Bordi, duke zgjedhur kryetarin me pozicion drejtues Zv. Kryeministër ose ministri që mbulon fushën e sipërmarrjes dhe biznesit, si dhe anëtarët nga një përfaqësues të nivelit të lartë politik të ministrive të linjës me pozicion drejtues Zv. Ministër, të cilët kanë përgjegjësi politike lidhur me strukturat e posaçme të inspektimit.

Projektvendimi përmban 7 këre, që në mënyrë të përmbledhur, parashikojnë sa më poshtë:

Kreu I, përcakton dispozita të përgjithshme, objektin dhe parimet që do të udhëheqin Bordin gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij.

Relacion për projektvendimin "Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve"

Kreu II, përcakton organizimin, përbërjen dhe funksionimin e Bordit, bazuar në fushat e veprimtarisë dhe politikat që ato përfaqësojnë në fushën e inspektimit, sipas ministritës së linjës. Janë përcaktuar funksionet që duhet të kenë kryetari dhe anëtarët e Bordit, kompetencat që ushtrojnë lidhur me bashkërendimin dhe orientimin e veprimtarisë së inspektimit, në bashkëpunim me Inspektorin e Përgjithshëm, për të garantuar standartet e përgjithshme të inspektimit.

Gjithashtu, përcakton qartë detyrat e Sekretariatit Teknik të Bordit, përgatit materialet për mbledhjen e bordit dhe mban proces verbalet e mbledhjeve, si dhe vendimet që merren në mbledhjet e Bordit. Përbërja e Sekretariatit Teknik i Bordit, miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm.

Kreu III, rregullon mënyrën e organizimit të thirrjes së mbledhjeve të Bordit dhe përcakton kohën e mbledhjes së bordit, ku mblidhet sa herë është i nevojshme shqyrtimi i një çështje, por jo më pak se 2 herë në vit, me nismën e kryetarit të Bordit, inspektorit të Përgjithshëm dhe të njërit nga anëtarët e bordit. Në mbledhjet e Bordit, duhet të jetë i pranishëm inspektori i Përgjithshëm ose zëvendësi i tij.

Kreu IV, përcakton rregulla përmarrjen e vendimit mbi bazën e dokumenteve të paraqitura përfundës së inspektuese, por në rastet kur e gjykon të nevojshme ai mund të marrë vendime edhe mbi bazën e informacioneve të paraqitura përfundës apo propozimeve të bëra gjatë diskutimit në mbledhje.

Kreu V, përcakton rregulla dhe afate përfundimit e vendimit të Bordit.

Kreu VI, përcakton rastet e lirimin dhe shkarkimit nga funksionet përfundës së kryetarin dhe anëtarët e Bordit.

Kreu VII, janë përcaktuar dispozitat kalimtare dhe organet e ngarkuara përfundës së zbatimin e këtij vendimi.

VII. INTITUCIONET DHE ORAGNET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Përfundës së zbatimin e projektvendimit ngarkohet Kryeministria, Ministritë e linjës dhe Inspektorati i Përgjithshëm.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit përfundës së Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjatë procesit të përgatitjes, projektakti është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në zbatim të *Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale përiorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, përfundës së zbatimit të ligjit përfundës së inspektimit, si dhe përfundës së zhvillimit të përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve 'e-Inspektimi'"*.

Relacion përfundës së zbatimit të projektvendimit "Përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve"

Projektakti do të dërgohet për mendim pranë Zëvendës Kryeministrit, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Enerjisë, Ministrinë e Financave, si dhe pranë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, në përputhje me kërkesat për konsultim ndërinstitucional dhe koordinimin e reformës në sistemin e inspektimeve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi shoqërohet me kosto financiare për buxhetin. Anëtarët e Bordit ushtrojnë veprimtarinë e tyre kundrejt shpërblimit. Masa e shpërblimit për kryetarin dhe anëtarët përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet e legjisacionit në fuqi për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve.

PROPOZUESI
MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT
DELINA IBRAHIMAJ

Relacion për projektvendimin “Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve”